Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	14.06.2022	24.06.2022

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.06.2022, OE "Vision Project", ka parashtruar ankesë me nr: 206/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Rregullimi i fushave sportive- dy vjeçar", me nr. të prokurimit: 657-22-3698-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Viti.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 520,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 26.04.2022, data e hapjes së ofertës: 06.06.2022.
Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Edhe pase pranimit te vendimit te Komunes se Viti-së kun a ka aprovuar si pjeserisht kerkesen per ri-shqyrtim nuk jemi te pajtuar me kete vendim:

Ne shpalljen e tenderit nga Komuna e Vitise shihet se kriteret e vendosura ne FDT nga ana e Autoritetit Kontraktues jane ne kundershtim me LPP dhe dispozitat ligjore te tij.

Ne kerkesat 8.1& 8.2 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare:

Kerkesa 1

Kerkesa e AK per OE e precizuar ne qarkullim me **pasqyrat financiare të audituara ne vlere mbi** 750,000.00 Euro **mund te zevendsohet e njejta me deklarata tatimore vjetore** te cilat shkarkohen nga faqja zyrtare e ATK-së.

Kerkesa

Te hiqet nga kerkesa **mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania- në bank në vlerë prej se paku 400,000.00 Euro ose dëshmi nga banka për qasje në kredi apo limit kreditor të aprovuar.,** sepse eshte kriter diskriminues dhe nuk eshte i bazuar ne LPPK.

Ne kerkesat 9.1& 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kerkesa 1.

Kerkesa per **për punet e kryera, minimum sa vlera e Planifikimit të këtij projekti në sferen e ndërtimit të ulët përkatesisht në fusha sportive te mbetet**, ndersa kerkesa **një referencë për fusha të njejta me tartam minimum 2000 m2**, mendojme se eshte **kriter shume diskriminues** sidomos m2 i hapesires, kjo lë dyshime te qarta ne perpilimin e dosjes.

Kerkesa

Te hiqet kriteri qe OE te ketë autorizim nga kompania e cila e lejon për të shtruar tartam, sepse eshte kerkese absurde dhe tendence e hapur per favorizim te nje apo me shume Operatori Ekonomik.

Kerkesa 3

Kerkesa 3.a.

Te hiqet kerkesa e AK qe **Operatori ekonomik duhet të ketë një Lead Auditor për ISO 14001 2015**, sepse eshte diskriminuese dhe jemi te bindur se eshte totalisht e panevojshme per kete aktivitet te prokurimit dhe e zvogelon ne mase te madhe mundesin e ofertimit per OE.

Kerkesa 3.c.

Te hiqet **Një (1) person për trajtimin e mbetjeve inerte**

Te hiqet **Një (1) person i për drenazhim të dheut** sepse nuk eshte i nevojshem.

Kërkesa 4. Lista e mjeteve të punës dhe atë së paku

Kamion kiper 5-8 T dhe Kamion kiper 3-5 T te hiqen sepse punen e tyre e kryejne edhe kamionet me kapacitet prej 10 m3

Prandaj Operatori Ekonomik:

Kerkojme nga Komuna e Vitise ,qe lenda te kthehet ne Rivendosjen e Kritereve dhe gjate Rivendosjes se kritereve te zbatoj dispozitat ligjore te shkelura me rastin e njoftimit per kontrate Sepse nga kriteret e vendosura shihet se eshte tendenca preferenciale per OE te caktuar per te diskriminuar OE te tjere .

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kerkesa:
1.Operatori ekonomik ose Grupi i OE duhet të dëshmon se ka qarkullim në tre vitet e fundit ne vlere mbi 750,000.00 Euro, sipas pasqyrave financiare te audituara. Kapital te mjaftueshem per realizimin e kontrates (mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania- në bank në vlerë prej se paku 400,000.00 Euro ose dëshmi nga banka për qasje në kredi apo limit kreditor të aprovuar.
Dëshmia:
Dëshmi 1: OE duhet të ofroj si dëshmi pasqyrat financiare të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit , si dhe duhet te bashkangjiten licenca e kompanisë për auditim e noterizuar.Një dëshmi nga banka të vulosur dhe nenshkruar se ka limit kreditor ose qasje në kredi.

Kapaciteti teknik dhe professional:
Kërkesa 1.Operatori ekonomik apo grupi i OE duhet te ofroje një vlerë për punet e kryera, minimum sa vlera e Planifikimit të këtij projekti në sferen e ndërtimit të ulët përkatesisht në fusha sportive, si dhe së paku një referencë për fusha të njejta me tartam minimum 2000 m2. OE te ketë autorizim nga kompania e cila e lejon për të shtruar tartam, si dhe të jetë sipas Iso Standart ISO 9001-2015 me certifkatë valide për produktin e tartamit.

Kërkesa 3: Certifikata ISO 14001-2015 në Sistemin e menaxhimit,në ndertim të larta, pune metalike. Operatori ekonomik duhet të ketë një Lead Auditor për ISO 14001 2015
Një (1) person për trajtimin e mbetjeve inerte.
Një (1) person i për drenazhim të dheut.

Kërkesa 4. Lista e mjeteve të punës dhe atë së paku:
Kamion kiper 5-8 T, Një (1) copë.
Kamion kiper 3-5 T.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij te parashtruar ne OSHP, pretendon se autoriteti kontraktues ka vendosur kritere diskriminuese me rastin e hartimit te kërkesave te dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate.

OE ankues, pretendon se kërkesa e DT-se, ku autoriteti kontaktues ka kërkuar qe: OE duhet të dëshmon se ka qarkullim në tre vitet e fundit ne vlere mbi 750,000.00 Euro, sipas pasqyrave financiare te audituara. Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës (mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania- në bank në vlerë prej se paku 400,000.00 Euro ose dëshmi nga banka për qasje në kredi apo limit kreditor të aprovuar. Eshte kriter diskriminues dhe se e njëjta kërkesë duhet te zëvendësohet me deklarata tatimore vjetore.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim nuk qëndron per faktin se kërkesa e cituar me larte eshte ne përputhje me nenin 26 te RrUOPP-se, ku thuhet: Në rast të kontratave me vlerë të madhe, kur Operatori ekonomik ka për të financuar zbatimin e kontratës, është e dobishme për të kërkuar shumë të caktuar të likuiditetit ose për të njëjtën vlere shënim premtues për kredi. Mund të sigurojë se Operatori ekonomik do të merr kredi nga banka në rast nevoje, ose kompania ka të holla (cash) dhe është në gjendje të zbatojë kontratën pa kredi.

OE ankues, poashtu pretendon se kerkesa nr: 1 e Kapacitetit teknik dhe professional, ku AK-ja, ka kërkuar: Operatori ekonomik apo grupi i OE duhet te ofroje një vlerë për punët e kryera, minimum sa vlera e Planifikimit të këtij projekti në sferen e ndërtimit të ulët përkatësisht në fusha sportive, si dhe së paku një referencë për fusha të njëjta me tartam minimum 2000 m2.

Eksperti shqyrtues, e vlerëson kete pretendim si te paqëndrueshëm per faktin se kërkesa per reference eshte ne eprputhje te plote me natyrën e aktivitetit te prokurimit, konkretisht ne harmoni te plot me nenin 27 te LPP-se.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues kërkon qe te kërkesa lidhur Iso standardet me nr: 14001-2015 në Sistemin e menaxhimit, në ndërtim të larta, pune metalike dhe kërkesa qe operatori ekonomik duhet të ketë një Lead Auditor për ISO 14001 2015dhe poashtu Një (1) person për trajtimin e mbetjeve inerte, një (1) person i për drenazhim të dheut, te hiqen me arsyetimin se janë kërkesa te panevojshme dhe diskriminuese.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky arsyetim i OE ankues për faktin se te gjitha kërkesat e cituara me larte janë ne përputhje me natyrën e aktivitetit te prokurimit siç përcaktohen ne nenin 27 te Ligjit per prokurim publik.

Sa i përket pretendimit te OE ankues, se poashtu duhet te hiqen si kërkesa nga lista e makinerisë: Kamioni kiper 5-8 T, Një (1) copë dhe Kamioni kiper 3-5 T, nuk qëndron sepse AK-ja me kete rast ka lejar hapësirën prej 5-8T, cila nuk mund te konsiderohet diskriminuese.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa njoftimi për kontratë i datës: 26.04.2022 të mbetet në fuqi.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KOMUNA VITI.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - VISION PROJECT.